



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:015740

Datë: 26.12.2023

Numri i dokumentit: 05123666

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.81/22

GJYKATA THEMELORE PEJË- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Leon Përlaska dhe procesmbajtësen Shpresa Kërnya, në çështjen penale kundër të pandehurit E. Gj. , për shkak të veprës penale në vazhdimësi “Rrezikimi i trafikut publik” nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë PP/II.nr.87/22 të datës 31.01.2022, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 20.12.2023, në prezencë të prokurorit të shtetit Dorjan Juniku dhe te pandehurit E. Gj. me mbrojtësin av.Besim Ahmetaj, me date 20.12.2023 shpalli, ndërsa me datë 26.12.2023 përpiloi këtë :

AKTGJYKIM

I pandehuri:

E. G., i lindur me datën: në Pejë, nga i ati S. dhe nëna K. e gjinisë Sh., me vendbanim në Rr. H. M. në Fsh. K.–Pejë, ka të kryer Fakultetin e Biznesit, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar me numër personal, i nacionalitetit Shqiptar/Kosovar, shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se:

Me datën 12.07.2021 rreth orës 12:40 në Udhëkryqin e Rrugës E. E. dhe Rrugës Mbretëresha T. në Pejë duke ngasur veturën e tij nga pakujdesia, ka shkelur Ligjin nr. 05/L-088 në Rregullat e Trafikut Rrugor (Neneve 33, 41, 42, 48, 53, 61 dhe 63) duke shkaktuar aksident trafiku me rrezikim të jetës së njerëzve dhe pasurisë dhe me këtë i shkakton dëm pasuror dhe lëndime të

rënda trupore të dëmtuarit E. H., në atë mënyrë që: në kohën dhe në vendin e lartëcekur duke lëvizur me veturën e tij të markës B. ... D me ngjyrë të zezë metalike, duke mos i kushtu vëmendje dhe rëndësi pjesëmarrësve tjerë në komunikacion dhe duke mos respektu përparësinë e kalimit të rregulluar me sinjalizim vertikal, i njëjti nga rruga dytësore Rr. E. E. pasi të arrin te udhëkryqi në rrugën kryesore Mbretëresha T. në mënyrë të pasigurtë dhe papritmas kthehet menjëherë në anën e majtë, duke ia pamundësuar lëvizjen e motoçikletës së të dëmtuarit në rrugë kryesore me ç'rast ia bllokoi rrugën të dëmtuarit ku si rezultat i dëmtuari me motoçikletën e tij përplaset në pjesën anësore të parë të anës së majtë të veturës së të pandehurit, e si pasojë i dëmtuari E. pëson lëndime të rënda trupore: ndrydhje dhe dërmishtje lëkurore dhe thyerje të kockës së radiusit të dorës së majtë, të shkaktuara nga mjeti mekanik i fortë i mbretë (jo i mprehtë), ndërsa i pandehuri pëson lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme në shëndet: ndrydhje në qafë të shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo të mprehtë);

- me çka ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga Neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 43,44,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

- Të pandehurit E. Gj. shqipton:

DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh i cili dënim me pëlqimin e te pandehurit i zëvendësohet me DENIM ME GJOBË ne lartësi prej nga 300 (treqind) euro, të cilin dënim detyrohet ta paguaj i pandehuri në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast qe i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.

- Të dënuarit i shqiptohet dënimi plotësues Ndalimi i drejtimit të automjetit te kategorië B dhe atë për periudhën një (1) vjeçare, e cila ndalesë do të zbatohet nga dita kur ky aktgjykim të marr formën e prerë.

- Obligohet i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

ARSYETIM

Historiku i çështjes, qëndrimet e palëve dhe fajësia ;

Prokuroria Themelore në Pejë pranë kësaj gjykatë ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr. 87/22 të datës 31.01.2022, kundër të pandehurit E. Gj., për shkak të veprës penale “Rrezikimi i trafikut publik” nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe par.1 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata me datë 20.12.2023 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën seancë prezantuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku dhe i pandehuri E. Gj. , me mbrojtës av. Besim Ahmetaj.

Pasi që gjykata u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën dhe veprën penale për të cilat akuzohet e ftoi të njëjtin që të deklarohet në lidhje me akuzën, ku i pandehuri e pranoi fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë.

Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri, gjykata e mori mendimin e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit në lidhje me pranimin e fajësisë të cilët i propozuan gjykatës që të aprovohet pranimi i fajësisë.

Gjykata duke u bazuar në nenin 242 par 2 dhe 6 të KPPRK-së vlerësoj se plotësohen kushtet ligjore për pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike, andaj gjykata e aprovoj pranimin e fajësisë si të tillë.

- Vendimi në lidhje me dënimin;

Gjykata kur vendosi në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit të përcaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në nenet 38, 39, 40, 42, 43,44 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074), dhe atë duke pasur parasysh qëllimin e dënimit, rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese të nxjerra nga faktet e çështjes dhe duke aplikuar udhëzuesin për politikë ndëshkimore të Gjykatës Supreme të Kosovës, si në vijim.

Kur vendosi në lidhje me dënimin kryesor gjykata u mbështet në nenin 40 par.1 pika 1.2 dhe nenin 42 par.1 si dispozita të përgjithshme dhe dispozitën e veçantë nga neni 370 par.8 lidhur me par.1 të KPRK-së që e përcakton veprën penale dhe dënimin për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri.

Neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së, përveç që përcakton veprën penale e përcakton edhe minimumin dhe maksimumin e dënimit, dënim me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet, ku pastaj gjykata duke u mbështetur në rrethanat e rastit konkret bëri individualizimin e dënimit për të pandehurin.

Duke pasur parasysh se në këtë çështje penale i pandehuri e pranoi fajësinë në fillim të shqyrtimit fillestar, gjykata nuk e pati mundësinë që të administroj provat e propozuara në aktakuzë, megjithatë me rastin e vlerësimit të pranimin të fajësisë dhe pas shikimit të shkresave të lëndës nga provat e bashkëngjitura dhe deklaratimet e palëve në seancën e shqyrtimit fillestar gjykata arriti që të nxjerr rrethanat të cilat janë përcaktuese për llojin dhe lartësinë e dënimit.

Në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit prokurori i shtetit deklaroi “ Duke marrur parasysh se këtu i akuzuari e pranoi fajësinë konform kushteve ligjore, nga gjykata kërkoj që te njëjtin ta shpall fajtor, ta dënoj sipas ligjit si dhe ta obligoj ne pagarjen e shpenzimeve te procedurës penale, ndërsa me rastin e përcaktimit te llojit dhe lartësisë se dënimit, pranimin e fajësisë ta marr si rrethane lehtësuese. Po ashtu bej përmirësimin e propozimit për dënim plotësues ashtu që ne vend te dënimit plotësueses marrja e lejes se vozitjes e cila do te nënkuptonte futjen e serishme ne provim për patentë shofer, ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale propozoj që përveç dënimit kryesor ti shqiptohet ndalimi për drejtimin e automjetit”.

Mbrojtësi i te pandehurit E. Gj., Av.Besim Ahmetaj deklaroi "I propozojmë gjykatës se si rrethane lehtësuese ta marr pranimin e fajësisë, faktin se i pandehuri me herët nuk ka kryer vepër tjetër penale dhe kërkojmë nga gjykata qe me rasti e shqiptimit te dënimit te pandehurit ti shqiptoj dënim sa me te bute, përkatësisht dënim me gjobë".

I pandehuri deklaroi " Pajtohem me deklarimin e mbrojtësit tim dhe shprehi keqardhje qe ka ndodhur ky rast".

Pas analizimit të provave të lartpërmendura dhe deklarimeve të palëve, gjykata nuk gjeti rrethana renduese për të pandehurin, ndërsa si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata gjeti, pranimin e fajësisë nga i pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar dhe keqardhja e shfaqur nga i pandehuri, si rrjedhojë gjykata vlerësoj rrethanat në kontekst të qëllimit të dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe erdhi në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në nenin 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074).

C. Dënimi me burgim dhe zëvendësimi me dënim me gjobë;

Gjykata pasi vlerësoi rrethanat e rastit të pandehurit i shqiptoj dënim më burgim prej 6 (gjashtë) muajsh, ku pasi qe mori pëlqimin e të pandehurit vendosi qe të bëjë zëvendësimin e dënimit me burgim me dënim më gjobë, e kjo në bazë të nenin 44 par. 1 të KPRK-së ku thuhet se "Kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj, gjykata njëkohësisht mund të vendosë që dënimi me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, me pëlqimin e personit të dënuar", e duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese të shprehura si me lartë gjykata erdhi në përfundim se ka bazë ligjore dhe faktike qe të bëhet zëvendësimi i dënimit, kjo pasi qe me lartësinë e gjobës së shqiptuar do të arrihet ne mënyre të mjaftueshme qe te pandehurit ti behet shumë e qartë përgjegjësia qe mban për veprimet e tij, e gjithashtu ky dënim do të shërbej si masë qe tek i njëjti të rris vetëdijen në lidhje me përgjegjësin e tij në raport me individin dhe shoqërinë.

Gjykata në dispozitiv të këtij aktgjykimi ka vendosur qe ndaj të pandehurit të shqiptoj dënim me gjobë në ne lartësi prej nga 300 (treqind) euro , të cilin dënim detyrohet ta paguaj i pandehuri në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast qe i pandehuri

nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë .

Dënimin më gjobë gjykata e shqiptoj duke u bazuar në faktin se për veprë penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri ligjvënësi ka paraparë shqiptimin e dënimit me burgim, mirëpo me pëlqimin e të pandehurit, gjykata beri zëvendësimin e dënimit me burgim me dënim me gjobë dhe atë duke u bazuar në nenin 43 par.1 dhe 2 dhe nenin 44 par.1 të KPRK-së, u vendos që të pandehurit t'i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, më bindjen se ky dënim do të arrijnë në mënyrë të mjaftueshme të shprehin gjykimin shoqëror për veprën e kryer.

Të pandehurit ju shqiptua edhe dënimi plotësues ndalimi i drejtimit të automjetit të kategorisë B dhe atë për periudhën një vjeçare, e cila ndalesë do të zbatohet nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e kjo me bindjen se ky dënim plotësues së bashku me dënimin kryesor do të ndikoj të i pandehuri për rritjen e vetëdijes dhe përgjegjësisë që duhet të ketë si pjesëmarrës në komunikacion.

Ky dënim plotësues u shqiptua në bazë të nenit 64 të KPRK-së ku thuhet "Kryesit të veprës penale, i cili rrezikon sigurinë në trafikun publik, gjykata mund t'ia ndalojë drejtimin e automjetit të llojit apo të kategorisë së caktuar. Gjkata cakton kohëzgjatjen e dënimit të urdhëruar sipas paragrafit 1. të këtij neni, kohëzgjatja e të cilit nuk mund të jetë më e shkurtër se një (1) vit e as më e gjatë se pesë (5) vjet, duke llogaritur nga dita kur vendimi merr formën e prerë. Koha e kaluar në burg apo në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi".

Gjkata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale të kryera nga i pandehuri.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Andaj, duke u mbështetur në fakte, provat dhe dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE PEJE

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.81/22, me datë 26.12.2023

Procesmbajtësja:

Shpresa Kërnja

Gjyqtari i vetëm gjykues:

Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.